



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 67/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muahmet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Ferizaj, për shkak se ka varur posterin në dy anët e rrugës gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 28.04.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.04.2012, nga subjekti politik LDK, me të cilën pretendohet se subjekti politik AAK, në rrugën “Dëshmorët e Kombit” ka vendosur posterin e kandidatit të subjektit politik AAK-së, për kryetar Komune të Ferizajit Naim Ferati, të varur në të dy anët e rrugës.

Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i, që të ndërmerren masat e parapara ligjore ndaj subjektit politik AAK.

Neni 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), përcakton se:

PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Neni 3 paragrafi 6 pika c, e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it përcakton:

(c) hollësi rreth çfarë do dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rast kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, për rastin konkret nuk pati çka të vlerëson nga provat ngase në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë provë e ofruar nga parashtruesi i ankesës lidhur me pretendimet theksuara në ankesë. PZAP-i, konstatoi se ankesa është e pabazuar, për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 3 paragrafi 6 pika c të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, andaj në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë

A nr. 67/2012 më datën 28.04.2012.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

